

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 1668 REP.

NR. 532 KOL.



KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë 12/09/2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) përpara meje noterit Gentiana Shkodra, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me zyrë në Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtme, të cilat bien dakord të lidhin këtë kontratë shitje kuotash e shoqërisë (në vijim e referuar si "**Kontrata**"):

- Shoqëria "**BIO ENERGY 15**" Shpk, NUIS L31729005P, me seli në Rruga e Elbasanit, Vila Nr. 71, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Sokol Meqemeja, shtetas shqiptar, i lindur më 28.06.1969, në Tiranë, me banim në Tiranë, I identifikuar me letërnjoftimin nr. 029875010, numër personal G90628152K me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim e referuar si "**BIO ENERGY 15**");
- Shoqëria "**ALSI & Co**" Shpk, NUIS L01516024Q, me seli në Vaqarr, Rruga e Prushit, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Roland Sino, shtetas shqiptar, i lindur më 22.09.1978, në Tiranë, me banim në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftimin nr. 025497712, numër personal H80922038H me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim e referuar si "**ALSI & Co**")"

BIO ENERGY 15 e ALSI & Co do t'iu bëhet referim sëbashku si "**Shitësit**",

- shoqëria **KISI-BIO-ENERGJI Shpk**, NUIS K86907701E, seli në Tiranë, Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, e përfaqësuar nga administratori i saj Z. Imer Memetaj, shtetas shqiptar, lindur më 17.05.1968, në Kocul, me banim në Tiranë, i identifikuar me letërnjoftimin nr. 032692904, numër personal G80517028W, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim e referuar si "**Shoqëria Konçesionare**");
- shoqëria **FREE CO Shpk**, NUIS L92015001P, me seli në Rr. Abdi Toptani, ndërtesa Torre Drin, kati 4, Ap. 10, Njesia Administrative nr. 2, Tiranë, e përfaqësuar nga administratorja Znj. Ledia Beçi, shtetase shqiptare, e lindur në Tiranë, më 23/06/1974, me banim në Tiranë, e identifikuar me letërnjoftimin nr. 03314003, numër personal H45623106B, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim e referuar si "**Blerësi**");

Palëve të mësipërme do t'iu bëhet referim në këtë Kontratë veçmas si "Pala" dhe sëbashku si "Palët".

Duke qenë se:

- A) Shoqëria Konçesionare është zotëuese ekskluzive dhe e ligjshme e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga kontrata e koncesionit BOT (në vijim e referuar si "**Kontrata e Konçesionit**") e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë (aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe shoqërisë KISI Shpk më datë 05.05.2008, me nr. 993 Rep., nr. 179 Kol., objekt shtesash dhe ndryshimesh mes palëve, për ndërtimin, vënien në punë dhe transferimin e hidrocentralit "Kacni" të ndodhur në Selishte, Dibër, me fuqi totale të instaluar prej 3.870 kW, prodhim vjetor energjie të vlerësuar në rreth 16.823.283 kWh, fee konçesionare 2% e energjisë së prodhuar (në vijim referuar si "**Konçesioni**" ose "**Projekti**");
- B) Shitësit janë ortakë të Shoqërisë Konçesionare, e cila ka një kapital të regjistruar në Datën e Nënshkrimit të barabartë me 422.700.000 Lek, ndarë në 2 kuota (në vijim të referuar si "**Kuotat**") që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, nga të cilat BIO ENERGY 15 Shpk zotëron një kuotë të barabartë me 90% të kapitalit të shoqërisë me vlerë të regjistruar prej 380.430.000 Lek dhe ALSI & CO Shpk zotëron një kuotë të barabartë me 10% të kapitalit të shoqërisë me vlerë të regjistruar prej 42.270.000 Lek, siç rezulton nga ekstrakti i Qendrës Kombëtare të Biznesit bashkëlidhur kësaj Kontrate;

- C) Shitësit dëshirojnë t'i shesin Blerësit të gjitha Kuotat e Shoqërisë Konçesionare që zotëron secili prej tyre, me vlerë kapitali nominal të barabartë me 422.700.000, që përbëjnë 100% të kapitalit të Shoqërisë Konçesionare ("**Pjesëmarrja**");
- D) Blerësi dëshiron të procedojë me blerjen e Pjesëmarrjes dhe lidhjen e kësaj Kontrate, pasi është njohur dhe ka vlerësuar dokumentacionin kontabël, financiar, ligjor dhe tatimor të Shoqërisë Konçesionare ("**Dokumentacioni i Shoqërisë**") i vendosur në dispozicion nga Shitësit dhe nga Shoqëria Konçesionare, duke mbajtur përgjegjësi të plotë Shitësit në lidhje me plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë e Dokumentacionit të Shoqërisë;
- E) Shitësit dhe Blerësi dëshirojnë të procedojnë me shitjen e Kuotave, duke lidhur këtë Kontratë, e cila rregullon kushtet, afatet dhe mënyrat me të cilat Blerësi do të blejë Pjesëmarrjen nga Shitësit;
- F) Shitja e Kuotave objekt e kësaj Kontrate është miratuar nga Asamblesë e Përgjithshme të Palëve, sipas vendimeve bashkëlidhur kësaj Kontrate, dhe nuk ekzistojnë kushte që mund të pengojnë lidhjen e kësaj Kontrate mes Palëve;
- G) Në datën e kësaj Kontrate, Kuotat e Shoqërisë Konçesionare rezultojnë të rënduara me barrë siguruese në favor të Raiffeisen Bank Abania Sha, siç rezulton nga vërtetimi i Regjistrimit të Barrëve Siguruese bashkëlidhur kësaj Kontrate;

Duke pasur parasysh sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 – Parashtrësat dhe shtojcat

- 1.1 Parashtrësat dhe shtojcat janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e kësaj Kontrate.

Neni 2 – Përkufizimet

- 2.1 Përveç termave dhe shprehjeve të përcaktuara në parashtrësat apo në klauzola të tjera të kësaj Kontrate, në kuptim të kësaj Kontrate: (i) termat dhe shprehjet e renditura më poshtë do të kenë kuptimin që përcaktohet në përkufizimin përkatës; (ii) termat në shumës do të kuptohet se i referohen edhe numrit njëjës dhe anasjelltas (iii) referimet në nene do të kuptohen se i referohen neneve të kësaj Kontrate.

"**Data e Mbylljes**": tregon datën e përfshirë në periudhën 30 shtator 2019 deri më 31 tetor 2019, për të cilën Palët do të bien dakord, në të cilën do të kryhen të gjitha veprimet e parashikuara në nenin 5.2 vijues.

"**Mbyllje**": tregon përmbushjet e treguara në nenin 5.2 vijues, të konsideruara në tërësinë e tyre.

"**Data e Nënshkrimit**": tregon datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

"**Nënshkrimi**": tregon nënshkrimin e kësaj Kontrate.

"**Autoriteti Kontraktues**": tregon Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë.

"**Transaksion**": tregon shitjen dhe transferimin e të gjitha Kuotave të Shoqërisë Konçesionare nga Shitësit tek Blerësi, të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 3 – Objekti i Kontratës

- 3.1 Në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në këtë Kontratë, Shitësit shesin dhe i transferojnë Blerësit, i cili ble nga Shitësit, të gjitha Kuotat e Shoqërisë Konçesionare që zotërohen nga Shitësit, të barabarta me 100% të kapitalit të shoqërisë, si më poshtë vijon:

- 3.1.1 BIO ENERGY 15 shet dhe transferon Kuotën e saj në Shoqërisë Konçesionare të barabartë me 90% të kapitalit të shoqërisë me vlerë të regjistruar në Nënshkrim të barabartë me 380.430.000 Lek;



- 3.1.2 ALSI & CO shet dhe transferon Kuotën e saj në Shoqërisë Konçesionare të barabartë me 10% të kapitalit të shoqërisë me vlerë të regjistruar në Nënshkrim të barabartë me 42.270.000 Lek.

Neni 4 – Vlera e Kontratës

- 4.1 Palët bien dakord se vlera e kësaj Kontrate (në vijim referuar si “Vlera e Kontratës”) është e barabartë me EUR 4.600.000 (katër milion e gjashtëqind mijë) dhe do të paguhet nga Blerësi sipas mënyrave të mëposhtme:

4.1.1 Në Datën e Mbylljes, Blerësi do të shlyejë financimin e kontraktuar nga Shoqëria Konçesionare pranë Raiffeisen Bank Sha i vlerësuar në shumën prej rreth 1.258.000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë e tetë) Euro në Datën e Nënshkrimit, me mënyra që do të bihen dakord me Raiffeisen Bank Sha dhe në formën e financimit të dhënë Shoqërisë Konçesionare, sipas vërtetimit të lëshuar nga Raiffeisen Bank Sha për gjendjen e financimit në Datën e Mbylljes dhe do të çlirojë Kuotat nga barrët sigurorese të regjistruara në favor të Raiffeisen Bank Sha;

4.1.2 Shuma prej rreth EUR 3.342.000 (tre milione e treqind e dyzet e dy mijë) përbën çmimin e shitjes (në vijim referuar si “Çmimi”) së Kuotave të Shoqërisë Konçesionare që do të paguhet nga Blerësi tek Shitësit, çmim i cili do të rregullohet dhe rakordohet në përputhje me nenin 4.1.1 dhe 4.4. Çmimi do të paguhet sipas mënyrave të mëposhtme:

(a) Shuma prej 250.000 Euro do të paguhet brenda 10 ditësh nga Data e Nënshkrimit në llogarinë escrow pranë noterit të zgjedhur nga Blerësi dhe do t’iu transferohet Shitësve:

i) Në Datën e Mbylljes në përputhje me afatet dhe kushtet e marrëveshjes escrow bashkëlidhur kësaj Kontrate;

ii) Përpara Datës së Mbylljes, në rast se Blerësi tërhiqet dhe zgjidh në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë për shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 8.1.3 të kësaj Kontrate.

(b) Shuma prej 500.000 Euro do të mbahet nga Blerësi si garanci dhe kompensim për kosto e detyrime të mundshme, të cilatdo lloji, që i përkasin periudhës deri në Datën e Mbylljes dhe që mund t’i lindin Shoqërisë Konçesionare ose Blerësit pas Mbylljes dhe/ose në lidhje me Transaksionin dhe do t’iu paguhet Shitësve brenda 6 (gjashtë) muajve nga Data e Mbylljes, përveç rasteve të kompensimit të mundshëm;

(c) Në Datën e Mbylljes, Blerësi do t’iu paguajë Shitësve shumën e mbetur të Çmimit, duke zbritur shumat e përcaktuara në nenet 4.1.2, paragrafët (a) dhe (b), duke rënë dakord Palët për rregullimet dhe rakordimet e Çmimit sipas nenit 4.4 të kësaj Kontrate.

4.2 Pagesa e Çmimit do të bëhet përpjesëtimisht me Kuotën që zotërojnë Shitësit në Shoqërinë Konçesionare (*pro quota*) nëpërmjet transferimit në llogarinë bankare të Shitësve si më poshtë vijon:

- BIO ENERGY 15 – llogaria bankare pranë Raiffeisen Bank, numri i llogarisë: 0011060805, SWIFT code: SGSBALTX, IBAN: AL78202112570000000011060805
- ALSI & CO - llogaria bankare pranë ProCredit Bank, numri i llogarisë: 140091740002, SWIFT code: FEFAALTRXXX, IBAN: AL75209110810000140091740002.

Shpenzimet dhe komisionet bankare të transfertave do të jenë në ngarkim të Blerësit.

4.3 Vlera e kësaj Kontrate përcaktohet për blerjen e të gjithë Pjesëmarrjes dhe të drejtave të Konçesionit nga Blerësit, i vlerësuar me parashikimin që hidrocentrali i Shoqërisë Konçesionare është tërësisht funksional, i lidhur me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe përfiton stimujt e parashikuar



për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për hidrocentralet me dimensione të njëjta dhe fuqi aktive në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka një kontratë shitje energjie (PEF) për blerjen e energjisë së prodhuar me kohëzgjatje deri më 27.05.2030, sipas kontratës së shitjes së energjisë të lidhur me OSHEE Sha datë 24.10.2016, nr. 24335 Prot.

- 4.4 Palët bien dakord dhe njohin se Çmimi është i bazuar në parimin “zero detyrime – zero të arkëtueshme” në Datën e Mbylljes dhe për pasojë Çmimi do të jetë objekt rregullimesh, në rritje apo në zbritje, në bazë të pozicionit financiar neto të Shoqërisë Konçesionare në Datën e Mbylljes. Çdo taksë e tatim zbatueshëm mbi Transaksionin do të jetë në ngarkim të Shitësve, duke e shkarkuar shprehimisht Blerësin dhe Shoqërinë Konçesionare nga çdo tatim dhe përgjegjësi tatimore.

Neni 5 – Përmbushje dhe kushte pezulluese në Mbyllje

- 5.1 Në Datën e Mbylljes do të realizohen njëkohësisht dhe do të përmbushen të gjitha detyrimet dhe kushtet e listuara në nenin 5.2. Këto kushte dhe përmbushje, të konsideruara në tërësinë tyre, do të përbëjnë Mbylljen. Të gjitha veprimet, operacionet dhe përmbushjet që përbëjnë Mbylljen dhe që listohen në nenin 5 do të konsiderohen si një operacion i vetëm dhe unik. Për rrjedhojë, asnjë veprim dhe/ose operacion që përbën Mbylljen nuk do të konsiderohet si i plotësuar apo i përmbushur në mënyrë efektive nëse operacionet apo përmbushjet e tjera nuk kanë ndodhur dhe nuk janë plotësuar të gjitha në mënyrë korrekte dhe, nëse njëra nga Palët do të rezultojë mospërmbushëse edhe për një prej këtyre detyrimeve sipas nenit 5.2 dhe/ose një prej këtyre kushteve nuk realizohet në përputhje me sa parashikohet në këtë Kontratë, Pala që nuk është në mospërmbushje do të ketë të drejtë të mos realizojë Mbylljen, duke ruajtur të drejtën për shpërblimin e dëmit të shkaktuar (nëse është e zbatueshme), dëmshpërblim i cili nuk mund të kërkohej kur mospërmbushja e njërit prej këtyre detyrimeve dhe/ose kushteve nuk është realizuar jo për fajin e Palës mospërmbushëse .

- 5.2 Palët bien dakord se transferimi i Kuotave nga Shitësit tek Blerësi dhe pagesa e Vlerës së kësaj Kontrate nga Blerësi iu nënshtrohen plotësisht të gjitha kushteve pezulluese brenda dhe jo më vonë se Data e Mbylljes, përveç kur Palët kanë rënë dakord me shkrim për shtyrjen e këtij afati:

- 5.2.1 Shitësit zvogëlojnë kapitalin e Shoqërisë Konçesionare nga 422.700.000 ALL në 202.600.000 ALL, duke:

- (a) Anuluar vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Konçesionare datë 20.07.2018, nr. 0708/1665 Prot. për korrigjimin e pasqyrave financiare të vitit 2017 dhe zmadhimin e mëpasshëm të kapitalit të shoqërisë;
- (b) Zvogëluar kapitalin e shoqërisë me shumën 7.700.000 ALL, i zmadhuar me kapitalizimin e fitimit neto për vitin ushtrimor 2018 dhe kapitalizimin e rezervave të tjera, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme datë 29.06.2019, nr. 0708/1805 Prot.

- 5.2.2 Autoriteti Kontraktues miraton me shkrim Transaksionin, përfshirë shitjen dhe transferimin e kuotës së ALSI % Co Shpk në favor të Blerësit, pa kufizime apo kushte për Blerësin. Realizimi i këtij kushti do të jetë nën kujdesin dhe përgjegjësinë e Shitësve. Në rast se realizimi i këtij kushti nuk plotësohet për shkaqe të pavarura nga vullneti i Shitësve dhe Shoqërisë Konçesionare, pavarësisht angazhimit maksimal të këtyre të fundit, Shitësit dhe Shoqëria Konçesionare nuk kanë asnjë detyrim dhe përgjegjësi ligjore dhe financiare ndaj Blerësit.

- 5.2.3 Pas miratimit të Transaksionit nga Autoriteti Kontraktues, sipas nenit 5.2.2, Blerësi do të përmbushë sa parashikohet në nenin 4.1.1 të kësaj Kontrate, duke u angazhuar Shitësit dhe Shoqëria Konçesionare për të lidhur të gjitha kontratat dhe për të kryer të gjitha veprimet përkatëse për këtë qëllim;

5.2.4 Kuotat janë të lira nga çdo barrë, peng, kufizim, transkriptim në regjistra publikë, përfshirë Regjistrin e Barrëve Siguruese dhe Regjistrin Tregtar dhe mund të transferohen nga Shitësit tek Blerësi;

5.2.5 Shitësit paraqesin bilancin e Shoqërisë Konçesionare për periudhën 01.01.2019 deri në Datën e Mbylljes dhe Palët rakordojnë dhe rregullojnë pjesën e mbetur të Çmimit sipas neneve 4.1.1 dhe 4.4 të Kontratës.

5.2.6 Shitësit i paraqesin Blerësit dorëheqjen e parevokueshme të administratorit të Shoqërisë Konçesionare, sipas modelit bashkëlidhur si shtojca 18 e kësaj Kontrate;

5.2.7 Shitësit i dorëzon Blerësit vërtetimin e lëshuar në Datën e Mbylljes nga autoritetet tatimore kompetente që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve, kontributeve dhe tatimeve nga Shoqëria Konçesionare, përfshirë taksat dhe detyrimet vendore deri në Datën e Mbylljes;

5.2.8 Shitësit i dorëzojnë Blerësit deklaratat me shkrim ose letër konfirmimi, sipas shtojcës 19 të kësaj Kontrate, dhe Statement Bankar të debitorëve dhe të kreditorëve të Shoqërisë Konçesionare, siç rezultojnë nga bilanci i periudhës nga 01.01.2019 deri më Datën e Mbylljes, që konfirmojnë shuarjen e detyrimeve dhe kredive të Shoqërisë Konçesionare,

5.2.9 Blerësi paguan pjesën e mbetur të Çmimit në favor të Shitësve, shumë e rakorduar dhe e rregulluar nga Palët sipas neneve 4.1.1 dhe 4.4 të kësaj Kontrate;

5.2.10 Me plotësimin e të gjitha kushteve pezulluese të parashikuara në nenin 5.2 të kësaj Kontrate, Palët do të nënshkruajnë një deklaratë noteriale për transferimin e titullit të pronësisë mbi Kuotat nga Shitësi tek Blerësi, sipas shtojcës 20 të kësaj Kontrate dhe duke filluar nga kjo datë Blerësi do të jetë pronar i ligjshëm dhe me të drejta të plota mbi Kuotat. Transferimi i Kuotave nga Shitësit tek Blerësi do të plotësohet me regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Bashkë me Deklaratën Noteriale të transferimit të pronësisë së Kuotave, palët do të nënshkruajnë edhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të HEC-it Kacni, të inventarizuar, sipas shtojcës 22 bashkëlidhur kësaj Kontrate.

5.3 Në Datën e Mbylljes, Shitësit:

5.3.1 do të kryejnë çdo veprim të nevojshëm për të mundësuar transferimin e plotë dhe efektiv të Pjesëmarrjes në favor të Blerësit;

5.3.2 do të nënshkruajnë dhe shkëmbejnë me Blerësin çdo akt tjetër të nevojshëm me qëllim transferimin tek Blerësi të pronësisë së plotë dhe disponimit të lirë të Pjesëmarrjes;

5.3.3 do t'i dorëzojnë Blerësit origjinalin ose kopjen e njëzuar nga noteri së të gjithë dokumentacionit që provon plotësimin e të gjitha kushteve pezulluese të Transaksionit.

5.4 Shitësit njohin dhe bien dakord se detyrimi i Blerësit për të blerë Kuotat dhe për të përmbushur detyrimet që i takojnë kësaj blerjeje është i kushtëzuar nga plotësimi i kushteve të mëposhtme në Datën e Mbylljes:

5.4.1 përmbushja e kujdesshme dhe në kohën e duhur nga Shitësit e të gjitha detyrimeve sipas nenit 5.2 të Kontratës, përpara ose njëkohësisht në Datën e Mbylljes;

5.4.2 nuk kanë ndodhur fakte, ngjarje ose mosveprime që përbëjnë një shkelje të deklarimeve dhe garancive të Shitësve sipas nenit 7 ose që janë të tilla që mund të çenojnë thelbësisht situatën ekonomike, financiare, fiskale apo ligjore të Shoqërisë Konçesionare;

- 5.4.3 kryerja në të njëjtën kohë e të gjitha formaliteteve të parashikuara në nenin e mësipërm 5.2 në Datën e Mbylljes.

Neni 6 – Deklarime dhe garanci të Blerësit

- 6.1 Blerësi i deklaron dhe u garanton Shitësve se:

- 6.1.1 Do të paguajë në mënyrë korrekte dhe përgjegjësi të plotë në favor të Shitësve, Vlerën e kësaj Kontrate, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Kontrate.
- 6.1.2 Blerësi ka dhe do të ketë në Datën e Mbylljes, të gjitha tagrat dhe autorizimet e nevojshme për të nënshkruar këtë Kontratë dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga kjo e fundit;
- 6.1.3 Nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe përmbushja e detyrimeve që burojnë nga ajo nuk janë dhe nuk do të jenë apo nuk do të shkaktojnë në Datën e Mbylljes kundërshtim apo shkelje të normave ligjore, rregulloreve, aktit të themelimit, statutit, akteve, marrëveshjeve apo angazhimi të zbatueshëm ose detyrues për Blerësin, si edhe nuk bien ndesh me urdhra të autoriteteve administrative e gjyqësore, kontrata e detyrime në të cilat Blerësi është palë apo është i detyruar të zbatojë;
- 6.1.4 Kjo Kontratë krijon për Blerësin detyrime të ligjshme dhe të vlefshme, në përputhje me kushtet, afatet dhe mënyrat e përcaktuara në këtë Kontratë;
- 6.1.5 Në ngarkim të Blerësit nuk ka dhe nuk do të ketë në Datën e Mbylljes, procedime likuidimi, administrimi të kontrolluar apo falimentimi.

Neni 7 – Deklarime dhe garanci të Shitësve


- 7.1 Shitësit i deklarojnë dhe i garantojnë Blerësit se:

- 7.1.1 Shitësit kanë dhe do të kenë në Datën e Mbylljes, të gjitha tagrat dhe autorizimet e nevojshme për të nënshkruar këtë Kontratë dhe për të përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga kjo e fundit;
- 7.1.2 Nënshkrimi i kësaj Kontrate dhe përmbushja e detyrimeve që burojnë nga ajo nuk janë dhe nuk do të jenë apo nuk do të shkaktojnë në Datën e Mbylljes kundërshtim apo shkelje të normave ligjore, rregulloreve, aktit të themelimit, statutit, akteve, marrëveshjeve apo angazhimi të zbatueshëm ose detyrues për Blerësin dhe Shoqërinë Konçesionare, si edhe nuk bien ndesh me urdhra të autoriteteve administrative e gjyqësore, kontrata e detyrime në të cilat Shitësit dhe Shoqëria Konçesionare janë palë apo janë të detyruar të zbatojnë;
- 7.1.3 Kjo Kontratë krijon për Shitësit dhe Shoqërinë Konçesionare detyrime të ligjshme dhe të vlefshme, në përputhje me kushtet, afatet dhe mënyrat e përcaktuara në këtë Kontratë;
- 7.1.4 Në ngarkim të Shitësve dhe të Shoqërisë Konçesionare nuk ka dhe nuk do të ketë në Datën e Mbylljes, procedime likuidimi, administrimi të kontrolluar apo falimentimi;
- 7.1.5 Shitësit dhe/ose Shoqëria Konçesionare kanë përmbushur rregullisht dhe plotësisht të gjitha detyrimet që burojnë nga Kontrata e Konçesionit, sipas afateve të përcaktuara në këtë të fundit. Kontrata e Konçesionit është e vlefshme dhe në fuqi dhe nuk ka shkak, kërkesa, njoftime apo pretendime mospërmbushjeje dhe/ose njoftime zgjidhjeje të Kontratës së Konçesionit nga Autoriteti Kontraktues (MIE) dhe nuk ka kërkim kushtesh penale dhe/ose kërtime shpërblimi dëmi nga Autoriteti Kontraktues (MIE) kundrejt Shoqërisë Konçesionare dhe/ose konçesionarit;

- 7.1.6 Shitësit marrin përsipër çdo përgjegjësi, duke e shkarkuar Blerësin shprehimisht nga çdo përgjegjësi, kosto, detyrim, kontribut dhe përmbushje, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të Shoqërisë Konçesionare dhe/ose në lidhje me Konçesionin dhe që i përket periudhës deri në Datën e Mbylljes, të cilitdo lloji dhe titulli, përfshirë por pa u kufizuar në kushte penale dhe dëme kontraktore dhe/ose jashtëkontraktore, kërkime të cilësdo shume dhe lloji, borxhe, detyrime, tarifa, taksa, tatime, pagesa të cilësdo shume dhe lloji, kthim shumash dhe financimesh;
- 7.1.7 Kapitali i paguar i Shoqërisë Konçesionare është 202.600.000 Leke dhe, deri në Datën e Mbylljes, Shitësit janë të detyruar të kryejnë të gjitha veprimet dhe përmbushjet e nevojshme për të zvogëluar kapitalin e shoqërisë dhe për të realizuar sa parashikohet në nenin 5.2.1 të kësaj Kontrate, duke qenë në ngarkimin ekskluziv të Shitësve çdo efekt, tatim dhe përgjegjësi tatimore. Përveç sa parashikohet në këtë nen, Shitësit nuk do të kryejnë veprime të tjera me kapitalin e Shoqërisë Konçesionare nga Data e Nënshkrimit e deri në Datën e Mbylljes;
- 7.1.8 Shitësit kanë titull pronësie të plotë, ekskluziv, të ligjshëm, të lirë dhe të disponueshëm mbi Kuotat e Shoqërisë Konçesionare dhe të drejtat e Konçesionit të cilat i janë kaluar Shoqërisë Konçesionare. Në Datën e Mbylljes, Kuotat nuk janë dhe nuk do të jenë objekt pengu, barrësimi apo kufizimi. Shitësit deklarojnë gjithashtu se nuk iu janë dhënë dhe nuk do t'i jepen të tretëve, nëpërmjet kontratës apo me çdo mjet tjetër, të drejta mbi Kuotat, mbi Shoqërinë Konçesionare apo mbi Konçesionin, përfshirë por pa u kufizuar në të drejta parabletje, premtim shitje, blerje, kalim, transferim ose të drejta të tjera të cilitdo lloji;
- 7.1.9 Shoqëria Konçesionare është themeluar dhe regjistruar në përputhje me dispozitat ligjore dhe parashikimet e Kontratës së Konçesionit, duke qenë zotëruese ekskluzive e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të Konçesionit dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paligjshmërinë apo konstatimin e pavlefshmërisë së themelimit/regjistrimit;
- 7.1.10 Shoqëria Konçesionare nuk është në gjendjen e paaftësisë paguese, nuk i është nënshtruar dhe nuk ekzistojnë shkaqe për hapjen e procedurave të falimentimit, administrimit të kontrolluar, likuidimit ose procedura të tjera të ngjashme dhe/ose të njëjta me sa më sipër;
- 7.1.11 Hidrocentrali i Kacnit është tërësisht në gjendje pune, i lidhur me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe përfiton nga skema mbështetëse për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për hidrocentralet me dimensione të njëjta dhe fuqi aktive në territorin shqiptar me kontratë të nënshkruar për shitjes së energjisë së prodhuar për një kohëzgjatje deri më datë 27.05.2030, sipas kontratës së shitjes së energjisë të lidhur me OSHEE Sha më datë 24.10.2016, nr. 24335 Prot.;
- 7.1.12 Shoqëria Konçesionare ka marrë rregullisht dhe në përputhje me dispozitat ligjore të gjitha lejet, liçensat, pëlqimet dhe autorizimet për ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit të Kacnit dhe këto leje, liçensa, pëlqime dhe autorizime janë të vlefshme dhe nuk ekzistojnë shkaqe për revokimin, anulimin apo rishikimin e tyre. Gjithashtu, Shoqëria Konçesionare ka fituar në mënyrë të vlefshme dhe të rregullt të drejtat e përdorimit për truallin ku shtrihet Projekti;
- 7.1.13 Shoqëria Konçesionare është administruar në mënyrë korrekte dhe të përgjegjshme nga Shitësit dhe nuk ka fakte, akte apo ngjarje që mund të prodhojnë efekte negative mbi Shoqërinë Konçesionare, të tilla si rritje kostosh, shpenzimesh, financimesh, interesash dhe detyrimesh;
- 7.1.14 Bilancet e Shoqërisë Konçesionare janë përgatitur në përputhje me dispozitat ligjore dhe parimet kontabël të zbatueshme dhe pasqyrojnë me qartësi, saktësi, vërtetësi dhe plotësi gjendjen pasurore, ekonomike dhe financiare, si edhe rezultatin e viteve ushtrimore të Shoqërisë Konçesionare për periudhat përkatëse referuese. Bilanci referuese për periudhën

01.01.2019 – 30.06.2019 (në vijim i referuar si “**Bilanci Referues**”), bashkëlidhur kësaj Kontrate, është i vërtetë, real, i plotë dhe përfaqëson me besnikëri gjendjen ekonomike, financiare dhe pasurore të Shoqërisë Konçesionare në datën e sipërpërmendur. Detyrimet dhe kreditë e Shoqërisë Konçesionare, të treguara në Bilancin Referues, janë të vetmet detyrime dhe kredi të Shoqërisë Konçesionare dhe Shitësit nuk kanë dijeni për ngjarje apo rrethana të tjera që mund të shkaktojnë në të ardhmen lindjen e detyrimeve dhe kredive të tjera të ndryshme nga ato të sipërpërmendura. Shoqëria Konçesionare nuk ka kontraktuar angazhime financiare afatmesme ose afatgjata të ndryshme nga ato që tregohen në Bilancin Referues, përjashtuar financimin e kontraktuar me Raiffeisen Bank Sha siç rezulton nga vërtetimi i datës 17.07.2019 bashkëlidhur kësaj Kontrate. Shoqëria Konçesionare ka mbajtur me rregullsi dhe kujdesin e duhur kontabilitetin dhe regjistrimet kontabël, si edhe komunikimet në lidhje me aktivitetin e saj, duke kryer në kohë të gjitha deklaratimet dhe pagesat sipas ligjit.

- 7.1.15 Shitësit dhe Shoqëria Konçesionare nuk kanë lidhur apo ekzekutuar marrëveshje, kontrata, mirëkuptime, transaksione që janë në konflikt interesi me interesin më të mirë të Shoqërisë Konçesionare ose që nuk janë me kushtet e tregut;
- 7.1.16 Shoqëria Konçesionare ka deklaruar dhe shlyer rregullisht, saktësisht, plotësisht dhe brenda afateve, të gjitha taksat, detyrimet, tatimet, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk është e përfshirë në veprime apo procedime administrative e gjyqësore, nuk rrezikon që këto akte të ndërmerren ndaj saj nga organet tatimore për vlerësimin dhe vjeljen e detyrimeve, kamatëvonesave, penaliteteve, njoftim vlerësimeve tatimore apo për mosshlyerjen e plotë të tyre. Nuk ka rrethana apo ngjarje lidhur me veprimet tregtare të Shoqërisë Konçesionare të tilla që të paraqesin rrezik për vlerësimin e detyrimeve tatimore dhe kërkimin nga autoritetet tatimore të shumave më të larta për tatime, sanksione, kamatëvonesa dhe penalitete, përtej atyre të paguara nga Shoqëria Konçesionare. Efektet dhe përgjegjësia në rast vlerësimesh tatimore që mund të shkaktojnë tatime, sanksione, kamatëvonesa dhe penalitete më të mëdha për Shoqërinë Konçesionare për periudhën deri në Datën e Mbylljes do të jenë ekskluzivisht në ngarkim të Shitësve;
- 7.1.17 Shoqëria Konçesionare ka ristrukturuar fuqinë punëtore dhe ka 10 punëmarrës në Datën e Nënshkrimit dhe i njofton Blerësit organigramën e re me emrat dhe mbiemrat e punëmarrësve. Shitësit marrin përsipër të gjitha kostot, detyrimet dhe kontributet në lidhje me zgjidhjen e kontratave të punës të punëmarrësve të Shoqërisë Konçesionare që janë larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të ndërmarrjes. Shoqëria Konçesionare do t'i dorëzojë Blerësit listën e punëmarrësve me të cilët është ndërprerë marrëdhënia e punësimit dhe dokumentacionin përkatës. Shoqëria Konçesionare ka paguar rregullisht pagat dhe shpërblimet përkatëse për personelin e saj, duke përfshirë të gjitha zërat dhe shumat që ka detyrimin të paguajë dhe ka kryer të gjitha deklaratimet, pagesat, mbajtjet në burim dhe pagesat e parashikuara me ligj, duke përfshirë por pa u kufizuar në ato që kanë të bëjnë me kontributet e sigurimeve shoqërore. Shoqëria Konçesionare nuk i ka dhënë, premtuar, në formë të shkruar ose verbalisht, personelit të saj asnjë preferim, bonus, çmim, përfitim apo promovim dhe as nuk ka mbajtur sjellje të tilla nga të cilat mund të lindin pritshmëri lidhur me përfitime të mundshme, shpërblime, bonuse, çmime ose promovime. Kontratat e punës në fuqi, nuk kanë kushte rënduese dhe jashtë tregut për marrëdhëniet që zakonisht zbatohen me profesionistët dhe për të gjitha shpenzimet e pagave sikurse rezulton qartësisht nga librat kontabël;
- 7.1.18 Shoqëria Konçesionare e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me normat ligjore dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe ka përmbushur të gjitha detyrimet në lidhje me fushën e sigurisë, higjienës dhe shëndetit në punë, parandalimin e aksidenteve dhe dëmtimeve në punë, masat e mbrojtjes nga zjarri, duke marrë përsipër Shitësit dhe Shoqëria Konçesionare çdo përgjegjësi dhe pasojë për periudhën deri në Datën e Mbylljes;
- 7.1.19 Shitësit nuk do të tjetërsojnë pasuri të Shoqërisë Konçesionare dhe nuk do të vendosin hipoteka, pengje, kufizime ose barrë mbi këto pasuri; nuk do të rrisin borxhin dhe/ose



ekspozimin e Shoqërisë Konçesionare, duke ushtruar një administrim korrekt dhe të përgjegjshëm të shoqërisë dhe në përgjithësi nuk do të kryejnë veprime që mund t'i shkaktojnë një dëm Shoqërisë Konçesionare ose Konçesionit, nuk do të pengojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e të drejtave nga Blerësi;

- 7.1.20 Shitësit do të marrin masa për të përmbushur të gjitha detyrimet dhe kushtet e parashikuara në nenin 5.2 të kësaj Kontrate;
- 7.1.21 Shoqëria Konçesionare nuk është e përfshirë në mosmarrëveshje të cilësdo natyre qofshin, në juridiksionin e gjykatave apo arbitrazhe;
- 7.1.22 Shoqëria Konçesionare, ortakët dhe administratori i saj nuk janë nën hetim e procedim penal dhe nuk janë të dënuar penalisht;
- 7.1.23 Shoqëria Konçesionare ka një detyrim financiar në shumën prej 2.568.700 (dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë kundrejt Building Construction Shpk në lidhje me punimet për ndërtimin e hidrocentralit Kacni dhe në Datën e Mbylljes do të dorëzojë Blerësit deklaratën noteriale të lëshuar nga Building Construction Shpk dhe Statement Bankar që konfirmojnë shuarjen e këtij detyrimi.
- 7.1.24 Z. Sokol Meqemeja do të leshojë deklaratë personale si garanci për Blerësin në lidhje detyrimet e Shoqërisë Konçesionare për periudhën deri në Datën e Mbylljes, sipas shtojcës 17 bashkëlidhur kësaj Kontrate.
- 7.2 Garancitë dhe deklaratimet e Shitësve sipas këtij neni përbëjnë kushte thelbësore të Transaksionit, duke u angazhuar Shitësit, pa u cenuar përgjegjësia e mundshme e tyre, për t'i komunikuar menjëherë Blerësit çdo rrethanë ose situatë për të cilën marrin dijeni pas Datës së Nënshkrimit dhe që mund të shkaktojë mospërputhje apo mospërmbushje me deklaratimet dhe garancitë e sipërpërmendura. Shitësit mbajnë përgjegjësi për vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e deklarimeve dhe garancive sipas këtij neni.
- 7.3 Garancitë dhe deklaratimet e Shitësve janë të sakta, të plota dhe të vërteta në Datën e Nënshkrimit dhe do të jenë edhe në Datën e Mbylljes. Të gjitha deklaratimet dhe garancitë e Shitësve të përmbajtura në nenin 7.1 të kësaj Kontrate do të jenë të vlefshme për 3 vite duke filluar nga Data e Mbylljes.
- 7.4 Të gjitha deklaratimet dhe garancitë e parashikuara në nenin 7.1 ose në pjesë të tjera të kësaj Kontrate angazhojnë personalisht dhe solidarisht Shitësit, të cilët marrin përsipër të gjithë përgjegjësinë në lidhje me vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë përmbajtjes së tyre. Shitësit janë solidarisht përgjegjës për shpërblimin e dëmit dhe ruajtjen të pacenuar sipas rastit të Blerësit ose të Shoqërisë Konçesionare, nga çdo dëm (përfshirë dëmet indirekte, shpenzimet ligjore, humbjet e fitimit), kosto, detyrim, humbje, diferenca vlerash që mund të vijnë për ngjarje që i takojnë apo që kanë lidhje me periudhën deri në Datën e Mbylljes si pasojë e:
- 7.4.1 Shkeljes ose pavërtetësisë së cilësdo prej garancive sipas nenit 7.1 më sipër;
- 7.4.2 Mospërmbushjes nga Shitësit e cilitdo prej detyrimeve të tyre sipas kësaj Kontrate, me përjashtim të pikës 5.2.2 të kësaj Kontrate;
- 7.4.3 Pretendimeve, çështjeve gjyqësore, kundërshtimeve apo mosmarrëveshjeve që ngrihen nga të tretët kundrejt Shoqërisë Konçesionare ose kundrejt Blerësit për fakte, ngjarje, veprime dhe mosveprime që kanë të bëjnë ose i përkasin periudhës deri në Datën e Mbylljes;
- 7.4.4 Çdo fakt tjetër, veprim, mosveprim apo ngjarje që ka të bëjë me Shoqërinë Konçesionare, i shkaktoar, i lidhur ose që ka ndodhur në çdo moment përpara Datës së Mbylljes.
- 7.5 Në rast se kërkohet dëmshpërblim, Blerësi do të informojë me shkrim Shitësit, me postë ose me email ("Kërkesa për Dëmshpërblim"), në lidhje me ngjarjet e përcaktuara në nenin pararendës 7.4

("Ngjarjet"). Kjo Kërkesë për Dëmshpërblim duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të Ngjarjeve si edhe një vlerësim të dëmit dhe të humbjeve që Blerësi çmon se janë pasojë e këtyre Ngjarjeve, bashkë me dokumentacionin mbështetës. Brenda 15 ditëve nga marrja e Kërkesës për Dëmshpërblim nga Shitësit, Palët do të takohen dhe do të shqyrtojnë Kërkesën për Dëmshpërblim dhe dokumentacionin mbështetës.

7.5.1 Nëse Palët bien dakord ose Shitësit e pranojnë Kërkesën për Dëmshpërblim, Blerësi mund të mbajë dhe të kompensojë Kërkesën për Dëmshpërblim nga Çmimi që do t'iu paguhet Shitësve dhe nëse ky kompensim nuk është i mundur ose nuk është i mjaftueshëm që të mbulojë Kërkesën për Dëmshpërblim, Shitësit janë të detyruar solidarisht t'i paguajnë Blerësit shumat për të cilat detyrohen, brenda dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e Kërkesës për Dëmshpërblim.

7.5.2 Në rast se Shitësit nuk e pranojnë apo e konsiderojnë të pabazë Kërkesën për Dëmshpërblim, atëherë:

(a) Nëse Kërkesa për Dëmshpërblim ngrihet brenda 6 (gjashtë) muajve nga Data e Mbylljes, Blerësi do të ketë të drejtë të mbajë nga pjesa e papaguar e Çmimit, sipas nenit 4.1.2 (b) të kësaj Kontrate, shumën e treguar në Kërkesën për Dëmshpërblim deri në zgjidhjen përfundimtare të Kërkesës për Dëmshpërblim që e shkarkon Shoqërinë Konçesionare dhe/ose Blerësin nga çdo kosto dhe pasojë financiare, për cilindo titull dhe shkak. Me zgjidhje përfundimtare të Kërkesës për Dëmshpërblim do të kuptohet përfundimi i gjykimit (kur është e zbatueshme) me vendim të formës së prerë të paankimueshëm apo objekt rekursi në Gjykatën e Lartë ose nëpërmjet marrëveshjes apo deklarates noteriale të palëve të interesuara që shprehimisht dhe qartësisht e çlirojnë Shoqërinë Konçesionare dhe/ose Blerësin nga çdo kosto, humbje dhe efekt financiar, për cilindo titull dhe shkak.

(b) Nëse Kërkesa për Dëmshpërblim ngrihet pasi kanë kaluar 6 (gjashtë) muaj nga Data e Mbylljes ose për shuma të cilat nuk mund të kompensohen me pjesën e Çmimit sipas nenit 4.1.2 (b) të kësaj Kontrate, Shitësit detyrohen në çdo rast të ruajnë të pacënuar Shoqërinë Konçesionare dhe/ose Blerësin nga çdo kosto, humbje dhe pasojë financiare, për cilindo titull dhe shkak, në përputhje me sa parashikohet në nenin 7.4 të kësaj Kontrate.

7.5.3 Në çdo rast, Shitësit do të ndërmarrin me shpenzimet e tyre të gjitha veprimet e nevojshme për ndjekjen, përfaqësimin dhe zgjidhjen përfundimisht në rrugë gjyqësore apo jashtëgjyqësore të Ngjarjes mbi të cilën mbështetet Kërkesa për Dëmshpërblim, duke marrë nga Blerësi prokurën dhe autorizimet e nevojshme për këtë qëllim. Blerësi do të ketë të drejtë të caktojë një përfaqësues të tij për të ndjekur dhe për t'u informuar mbi veprimet dhe hapat që do të ndiqen nga Shitësit për zgjidhjen përfundimisht të Kërkesës për Dëmshpërblim, si edhe për të marrë kopje të dokumentacionit përkatës nga Shitësit apo përfaqësuesit e tyre. Blerësi ruan të drejtën të ndërhyjë dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për këtë qëllim në rast se Shitësit ose përfaqësuesit e tyre nuk sigurojnë mbrojtje juridike të përshtatshme, të kujdesshme dhe profesionale për interesat dhe të drejtat e Shoqërisë Konçesionare;

7.5.4 Palët bien shprehimisht dakord se në çdo rast efektet dhe pasojat e Kërkesës për Dëmshpërblim do të jenë në ngarkim dhe në përgjegjësinë ekskluzive të Shitësve, duke e ruajtur të pacënuar Blerësin dhe Shoqërinë Konçesionare nga çdo pasojë, detyrim, humbje, dëm, fitim i munguar, kosto financiare apo shpenzim.

7.5.5 Blerësi ka të drejtë të paraqesë një Kërkesë për Dëmshpërblim ndaj Shitësve vetëm brenda 3 vitesh duke filluar nga Data e Mbylljes.

Neni 8 – Zgjidhja e Kontratës

8.1 Palët bien dakord se kjo Kontratë zgjidhet vetëm në rastet e mëposhtme:

8.1.1 Me pëlqimin me shkrim së të gjitha Palëve;

8.1.2 Nga Shitësit në rast mospagimi të Çmimit nga Blerësi sipas afateve të përcaktuara në këtë Kontratë;

8.1.3 Nga Blerësi në rast shkelje të garancive dhe deklarimeve të Shitësit sipas nenit 7.1 të kësaj Kontrate ose në rast shkeljeje të kësaj Kontrate nga Shitësit dhe/ose Shoqëria Konçesionare;

- 8.1.4 Revokimi i Konçesionit ose zgjidhja e Kontratës së Konçesionit deri në Datën e Mbylljes dhe për fakte, veprime, ngjarje apo mosveprime që kanë ndodhur apo i përkasin periudhës deri në Datën e Mbylljes, përbën një kusht shprehimisht zgjidhës së kësaj Kontrate;
- 8.1.5 Mosrealizimi i Mbylljes brenda dhe jo më vonë se Data e Mbylljes, përveç rastit kur Palët kanë rënë dakord me shkrim për shtyrjen e këtij afati, ose mosmiratimi i Transaksionit nga Autoriteti Kontraktues, sipas kushteve të kësaj Kontrate, përbën një kusht shprehimisht zgjidhës së kësaj Kontrate, pa qenë e nevojshme që të kryhen veprime dhe njoftime të mëtejshme nga Palët.

- 8.2 Pala që synon zgjidhjen e Kontratës në rastet e parashikuara në nenet 8.1.2 dhe 8.1.3 do të njoftojë me shkrim Palën mospërmbushëse, duke treguar shkakun specifik të mospërmbushjes dhe dokumentacionin mbështetës e Pala mospërmbushëse do të ketë në dispozicion një afat maksimal prej 15 ditësh për të eliminuar mospërmbushjen. Me kalimin e këtij afati pa u eliminuar mospërmbushja, Palët mund të zgjidhin këtë Kontratë duke njoftuar me shkrim Palët e tjera, në respektim të një afati minimal njoftimi prej 7 ditësh.

Neni 9 – Dispozita të ndryshme

- 9.1 Kjo Kontratë nuk mund t'iu kalohet apo transferohet të tretëve, tërësisht apo pjesërisht, pa pëlqimin me shkrim së të gjitha Palëve. Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm me marrëveshjen me shkrim së të gjitha Palëve.
- 9.2 Secila Palë do të jetë përgjegjëse për shpenzimet në lidhje me negocimin, përgatitjen dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Shpenzimet noteriale do të ndahen në mënyrë të barabartë mes Shitësve dhe Blerësit.
- 9.3 Çdo njoftim që duhet të dërgohet sipas kësaj Kontrate duhet të hartohet në gjuhën shqipe, të dorëzohet dorazi apo me letër rekomande me kthim përgjigje, me korrier apo mjet tjetër që konfirmon marrjen, në adresat e Palëve të parashikuara në këtë Kontratë apo në adresa të tjera që do të komunikohen me shkrim nga Palët.
- 9.4 Toleranca e mundshme e njëres prej Palëve ndaj sjelljes së Palës tjetër në shkelje të dispozitave të kësaj Kontrate nuk mund të interpretohet si heqje dorë nga të drejtat që burojnë nga dispozitat e shkelura ose nga e drejta për t'iu kërkuar Palëve të përmbushin detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.
- 9.5 Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje apo kundërshtim mes Palëve që mund të lindë në lidhje me këtë Kontratë, përfshirë por pa u kufizuar në mosmarrëveshjet në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin dhe/ose zgjidhjen e kësaj Kontrate do të jetë fillimisht objekt diskutimi miqësor mes Palëve, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh nga lindja e mosmarrëveshjes apo nga data në të cilën mosmarrëveshja është komunikuar me shkrim nga njëra prej Palëve. Në rast se mosmarrëveshjet nuk do të zgjidhen miqësisht, zgjidhja e tyre do të jetë në gjykimin ekskluziv të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 9.6 Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.
- 9.7 Kjo Kontratë hartohet dhe nënshkruhet nga Palët në 5 (pesë) ekzemplarë në gjuhën shqipe me një përkthim në gjuhën italiane.

I bashkëlidhen kësaj Kontrate aktet e mëposhtme:

- 1) Ekstrakt i QKB-së për BIO ENERGY 15 Shpk;
- 2) Ekstrakt i QKB-së për ALSI & Co Shpk;
- 3) Ekstrakt i QKB-së për KISI-BIO-ENERGJI Shpk;
- 4) Ekstrakt i QKB-së për FREE CO Shpk;
- 5) Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të BIO ENERGY 15 Shpk datë 12/09/2019;



- 6) Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme i ALSI & Co Shpk datë 12/09/2019;
- 7) Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme i KISI-BIO-ENERGJI Shpk datë 12/09/2019;
- 8) Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme i FREE CO Shpk del 14/08/2019;
- 9) Ekstrakt i RBS-së datë 12/09/2019 për KISI-BIO-ENERGJI Shpk;
- 10) Vërtetim i Raiffeisen Bank Sha datë 17.07.2019;
- 11) Bilanci Referues i KISI-BIO-ENERGJI Shpk për periudhën 01.01.2019 – 30.06.2019;
- 12) Lista e debitorëve dhe kreditorëve të KISI-BIO-ENERGJI Shpk më datë 12/09/2019 me shumat përkatëse;
- 13) Lista e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshëm të KISI-BIO-ENERGJI Shpk;
- 14) Lista e punëmarrësve të KISI-BIO-ENERGJI Shpk me pagat mujore bruto;
- 15) Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme i KISI-BIO-ENERGJI Shpk datë 20.07.2018, nr. 0708/1665 Prot.
- 16) Marrëveshje escrow e lidhur me Palëve;
- 17) Deklaratë noteriale e lëshuar nga Z. Sokol Meqemeja;
- 18) Model letër dorëheqje e administratorit të KISI-BIO-ENERGJI Shpk;
- 19) Model letra kreditorësh dhe debitorësh të KISI-BIO-ENERGJI Shpk për t'u paraqitur në Mbyllje;
- 20) Model deklaratë noteriale e Mbylljes;
- 21) Deklaratë noteriale e Building Construction Shpk për t'u lëshuar në Mbyllje.
- 22) Model procesverbal i marrjes në dorëzim të HEC-it Kacni

Kjo kontratë iu lexohet palëve me zë të lartë, dhe pasi palët deklarojnë se kjo kontratë është në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë rregullisht kontratë përpara meje noterit dhe unë noter i vërtetoj nënshkrimin sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

SHITËSIT

Sokol Meqemeja
 BIO ENERGY 15 SHPK
 Administrator Z. Sokol Meqemeja

ALSI & CO SHPK
 Administrator Z. Roland Sino

SHOQËRIA KONÇESIONARE KISI-BIO-ENERGJI SHPK

Imer Memetaj
 Administrator Z. Imer Memetaj

BLERËSI

Ledia Beçi
 FREE CO SHPK
 Administrator Znj. Ledia Beçi



NOTERE



[Signature]

REPUBBLICA D'ALBANIA
CAMERA NOTARILE DI TIRANA

N. 1668 REP.

N. 552 RACC.

CONTRATTO DI VENDITA DI QUOTE SOCIETARIE

Addi, 12/09/2019 (duemiladiciannove) davanti a me il notaio pubblico Gentiana Shkodra, membro del Collegio Notarile di Tirana, con ufficio in Tirana, sono comparse le seguenti parti, le quali convengono e stipulano il presente contratto di vendita di quote societarie (in seguito riferito come "**Contratto**");

- La società "**BIO ENERGY 15**" Shpk, NUIS L31729005P, con sede in Rruga e Elbasanit, Vila Nr. 71, Tirana, Albania, rappresentata dal suo amministratore il Sig. Sokol Meqemeja, cittadino albanese, nato il 28.06.1969, in Tirana, residente a Tirana, identificato con il documento d'identità n. 029875010, numero personale G90628152K, con piena capacità giuridica e di agire, (in seguito riferita come "**BIO ENERGY 15**");
- la società "**ALSI & Co**" Shpk, NUIS L01516024Q, con sede in Vaqarr, Rruga e Prushit, Tirana, Albania, rappresentata dal suo amministratore il Sig. Roland Sino, cittadino albanese, nato il 22.09.1978, in Tirana, residente a Tirana, identificato con il documento d'identità n. 025497712, numero personale H80922038H, con piena capacità giuridica e di agire, (in seguito riferita come "**ALSI & Co**")

BIO ENERGY 15 e ALSI & Co saranno riferiti congiuntamente come "**Venditori**",

- la società **KISI-BIO-ENERGJI** Shpk, NUIS K86907701E, con sede in Tirana, Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, rappresentata dal suo amministratore il sig. Imer Memetaj, cittadino albanese, nato in Kocul, il 17.05.1968, residente in Tirana, con documento d'identità n. 032692904, numero personale G80517028W, con piena capacità giuridica e di agire (in seguito riferita come "**Società Concessionaria**");
- La società **FREE CO** Shpk, NUIS L92015001P, con sede in Rr. Abdi Toptani, ndertesa Torre Drin, kati 4, Ap. 10, Njesia Administrative nr. 2, Tirana, rappresentata dal suo amministratore la Sig.ra Ledia Beçi, cittadina albanese, nata in Tirana, il 23/06/1974, residente in Tirana, con documento d'identità n. 03314003, numero personale H45623106B (in seguito riferito come "**Acquirente**");

Le suddette parti saranno riferite nel presente Contratto singolarmente come "Parte" e congiuntamente come le "Parti".

Premesso che:

- A) La Società Concessionaria è legittima ed esclusiva titolare di tutti i diritti e obblighi derivanti dal contratto di concessione BOT (riferito in seguito come "**Contratto di Concessione**") stipulato tra il Ministero dell'Economia, Commercio ed Energia della Repubblica d'Albania (attualmente il Ministero dell'Infrastruttura ed Energia) e la società KISI Shpk in data 05.05.2008, con n. 993 Rep., n. 179 Racc., oggetto di addendum e modifiche tra le parti, per la costruzione, utilizzo e trasferimento della centrale idroelettrica di "Kacni" situata in Selishte, Diber, con potenza installata complessiva di 3.870 kW, produzione annua di energia stimata in circa 16.823.283 kWh, fee concessionaria 2% dell'energia prodotta (di seguito riferito come "**Concessione**" o "**Progetto**");
- B) I Venditori sono soci della Società Concessionaria che ha un capitale sociale registrato alla Data del Signing pari a 422.700.000 Lek, suddiviso in 2 quote (in seguito riferito come "**Quote**") che



rappresentano il 100% del capitale sociale, di cui BIO ENERGY 15 Shpk detiene una quota pari al 90% del capitale sociale con valore registrato pari a 380.430.000 Lek e ALSI & CO Shpk detiene una quota pari al 10% del capitale sociale con valore registrato pari a 42.270.000 Lek, come risulta dalla visura del Centro Nazionale del Business allegata al presente Contratto;

- C) È intenzione dei Venditori vendere all'Acquirente tutte le Quote della Società Concessionaria da ciascuno di essi detenute, costituito da complessive quote di valore nominale di ALL 422.700.000, corrispondenti al 100 % del capitale della Società Concessionaria (la "**Partecipazione**");
- D) L'Acquirente è intenzionato a procedere all'acquisizione della Partecipazione e alla stipula del presente Contratto, dopo avere visionato e valutato la documentazione contabile, finanziaria, legale e fiscale della Società Concessionaria (la "**Documentazione Sociale**") messa a disposizione dai Venditori e dalla Società Concessionaria, essendo pienamente responsabile i Venditori in merito alla completezza, veridicità ed esattezza della Documentazione Sociale;
- E) I Venditori e l'Acquirente intendono procedere alla cessione delle Quote, stipulando il presente Contratto, il quale regola condizioni, termini e modalità con cui l'Acquirente acquisirà la Partecipazione dai Venditori;
- F) La cessione delle Quote oggetto del presente Contratto è stata approvata dalle Assemblee Generali delle Parti, in base alle delibere allegate al presente Contratto, e non sussistono condizioni che possano impedire la stipula del presente Contratto tra le Parti;
- G) Alla data del presente Contratto, le Quote della Società Concessionaria risultano gravate da pegno non possessorio iscritto a favore di Raiffeisen Bank Abania Sha, come risulta da certificato del Registro dei Pegni non Possessori allegato al presente Contratto;

Tutto ciò premesso, le Parti convengono quanto segue:

Articolo 1 – Premesse ed allegati

- 1.1 Le premesse e gli allegati sono parte integrante e sostanziale del presente Contratto.

Articolo 2 – Definizioni

- 2.1 In aggiunta ai termini ed alle espressioni definiti nelle premesse o in altre clausole di questo Contratto, ai fini dello stesso: (i) i termini e le espressioni di seguito elencati hanno il significato in appresso indicato per ciascuno di essi; (ii) i termini definiti al plurale si intendono definiti anche al singolare, e viceversa; (iii) i riferimenti ad articoli sono intesi come riferimenti agli articoli del presente Contratto.

"**Data del Closing**": indica una data compresa nel periodo dal 30 settembre 2019 sino al 31 ottobre 2019, da concordarsi tra le Parti, in cui saranno compiute tutte le attività di cui al successivo articolo 5.2.

"**Closing**": indica gli adempimenti indicati al successivo articolo 5.2, unitariamente considerati.

"**Data del Signing**": indica la data di sottoscrizione del presente Contratto.

"**Signing**": indica la sottoscrizione del presente Contratto.

"**Autorità Contraente**": indica il Ministero dell'Infrastruttura ed Energia della Repubblica d'Albania.

"**Transazione**": indica la cessione e il trasferimento di tutte le Quote della Società Concessionaria dai Venditori a favore dell'Acquirente, costituenti il 100% del capitale sociale.



Articolo 3 – Oggetto del Contratto

- 3.1 Ai termini ed alle condizioni tutte previsti dal presente Contratto, i Venditori vendono e trasferiscono all'Acquirente, che acquista dai Venditori, tutte le Quote della Società Concessionaria da loro complessivamente detenute, pari al 100% del capitale sociale, come in seguito specificato:
- 3.1.1 BIO ENERGY 15 vende e trasferisce la sua Quota nella Società Concessionaria pari al 90% del capitale sociale con valore registrato al Signing pari a 380.430.000 Lek;
- 3.1.2 ALSI & CO vende e trasferisce la sua Quota nella Società Concessionaria pari al 10% del capitale sociale con valore registrato al Signing pari a 42.270.000 Lek.

Articolo 4 – Il valore del Contratto

- 4.1 Le Parti convengono che il valore del presente Contratto (in seguito riferito come “**Valore del Contratto**”) è pari a EUR 4.600.000 (quattromilioniseicentomila) e sarà versato dall'Acquirente secondo le seguenti modalità:
